

Aneksi A**SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Ekspert Licensimi (Jurist)	Reparti Ushtarak nr.6028, AIM	Tiranë	Pa afat	Po	Po	27.02.2025	13.03.2025
2								

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Ekspert Licensimi (Jurist)
2. Kodi i pozicionit: N/A
3. Reparti/Institucioni: Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, në Agjencinë e Industrisë së Mbrojtjes.Reparti Ushtarak Nr.6028,
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: VKM nr.325, datë 31.05.2023, i ndryshuar
6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat
7. Data e fillimit të aplikimit: 27.02.2025
8. Data e mbylljes së aplikimit: 13.03.2025
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në: <i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i> <i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i> <i>Tiranë</i>

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar së bashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV).
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike www.mod.gov.al. (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: Ekspert Armatim-municioni.
Arsimi : I lartë universitar “Master Shkencor” me 120 kredite në Shkenca Shoqërore/Drejtësi edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë.
- b. Kualifikimi: Në fushën e lartëpërmendur lidhur me procedurat administrative.
- c. Trajnimi: Trajnime në fushën e juridike.
- d. Eksperienca në Punë: Të ketë minimalisht 5 vjet eksperiencë në institucione të administratës publike në procese pune që lidhen me bashkëpunimin ndërinstitutional me institucionet e sigurisë dhe të inteligjencës në funksion të hetimeve administrative dhe verifikimit të sigurisë: Procese pune që lidhen me hartimin e akteve

	ligjore e nënligjore; Procese pune që lidhen me verifikimin e përputhshmërisë së procesve ligjore; Procese pune që lidhen me kryerjen e verifikimeve ligjore dhe përgatitje raporti, analizë, inspektim. e. Gjuha e huaj: Njohuri të mira të gjuhës Anglisht. f. Kërkesa të tjera specifike: Të ketë njohuri të mira në përdorimin e programeve kryesore të kompjuterit. g. Niveli i certifikatës së sigurisë: sipas VKM nr. 731, datë 27.11.2024 “Për miratimin e rregulores për sigurinë e personelit”.
	Përshkrimi i punës: Eksperti i Licencimit (Jurist) ka si mision të sigurojë që aktiviteti i licencimit të realizohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat rregullojnë procesin e licencimit dhe autorizimit të operatorëve ekonomikë për kryerjen e veprimtarive të prodhimit, magazinimit, transportimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake. Detyrat kryesore: ➤ Shqyrton dhe vlerëson aplikimet për licencë dhe autorizim për të siguruar që ato të plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore. ➤ Verifikon informacionin dhe dokumentacionin që shoqëron aplikimin për licencë, apo autorizim, duke verifikuar nëse aplikantët përmbushin kriteret e përgjithshme si dhe kriteret specifike për dhënien e licencave dhe autorizimit. ➤ Harton raporte për procesin e licencimit dhe autorizimit, duke përfshirë statistikën dhe analizat mbi numrin e aplikimeve, miratimet, revokimet, refuzimet. ➤ Kthen për plotësim praktikën në rast konstatimi të mangësisë së dokumentacionit. ➤ Kryen detyra të tjera të ngarkuara me urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm.
	13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve: Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një komision vlerësimi i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin: ▪ përzgjedhjen paraprake; ▪ vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse; ▪ intervistën e strukturuar me gojë. Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista, zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.